



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 676 Prot.

Datë 08.05.2014

Lënda: Dërgohet Vendimi Nr. 13, datë 07.03.2014 i KKT

Drejtuar: Z. Sotiraq Filo
Kryetar,
Bashkia Korçë

1153
12.5.14

I nderuar z. Filo,

Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 07.03.2014 ka marrë vendimin Nr. 13 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë” në përputhje me ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” i ndryshuar.

Vendimi është sigluar nga Sekretarja e K.K.T-së, Zëvendës Kryetarja e K.K.T-së, si dhe nga Kryetari i K.K.T-së. Gjithashtu, dokumentacioni bashkëlidhur vendimit, përkatësisht Harta e Propozuar e Përdorimit të Tokës dhe Harta e Infrastrukturës Rrugore së Propozuar, janë sigluar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Korçë, Kryetari i Bashkisë Korçë si dhe nga Kryetari i K.K.T-së.

Bashkëlidhur Ju lutem gjeni dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimi Nr. 13, i K.K.T-së, datë 07.03.2014;
- Harta e Propozuar e Përdorimit të Tokës;
- Harta e Infrastrukturës së Propozuar.

Me respekt,

Adelina GRECA

Adelina Greca

DREJTORE E PËRGJITHSHME



APP KZHU

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, Datë 07.03.2014

P Ë R

**MIRATIMIN E INSTRUMENTIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË
KORÇË**

Në mbështetje të neneve 8/1, pikat 1 dhe 3, dhe 27 të Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Kreut III “Planifikimi Vendor” të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr 887, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Korçë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.
2. Pjesë përbërëse e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor janë:
 - a. Politika e Zhvillimit të Territorit,
 - b. Plani i Përgjithshëm Vendor,
 - c. Rregullorja Vendore e Planifikimit,
 - d. Materiali grafik (harta).
3. Pjesa e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor që parashikon zhvillime në kategorinë “tokë bujqësore”, sikurse evidentuar në materialin grafik përkatës, hyn në fuqi vetëm në rast se parashikimi është për zhvillime ekonomike dhe mbi të gjitha, vetëm pasi të realizohet konvertimi i kategorisë së resursit “tokë bujqësore” në kategorinë e resursit “tokë urbane”, sipas legjislacionit sektorial në fuqi.





4. Pjesa e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor që parashikon ndryshimet e kufijve ekzistues të zonës së mbrojtur dhe qendrës historike duhet të garantojë në çdo rast ruajtjen e objekteve me vlera të veçanta të trashëgimisë arkitektonike dhe kulturore.
5. Ngarkohet Bashkia Korçë të kryejë bashkërendimin me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në lidhje me zbatimin e pikës 3.
6. Ngarkohet Bashkia Korçë të kryejë bashkërendimin me Ministrinë Kulturore në lidhje me zbatimin e pikës 4, për klasifikimin e objekteve me vlera të veçanta të trashëgimisë arkitektonike dhe kulturore brenda zonës aktuale të mbrojtur dhe qendrës aktuale historike si edhe për ruajtjen e tyre në mënyrë që zhvillimet e reja të mos çenojnë këto vlera.
7. Ngarkohet Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT